

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE

STATUT-RREGULLORE
E FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË BURIMEVE
NATYRORE

KREU I
THEMELIMI, OBJEKTI, EMËRTIMI, VULA

Neni 1

Statusi Juridik i Agjencisë

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, është person juridik, ent publik, në varësi të Ministrit të përgjegjës për energjinë, e krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, i ndryshuar.

Neni 2

Objekti i Veprimtarisë

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Vendimin Nr. 547, datë 09.08.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, i ndryshuar, si dhe konform Statut-Rregullores. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka objekt të veprimtarisë së saj zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjitik.

Neni 3

Selia, Vula Zyrtare dhe Stema

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore me seli në Tiranë dhe adresë: Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, ka vulën dhe logon e saj, të miratuar nga Ministri.

Neni 4

Financimi dhe Burimet e Financimit

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, nuk financohet nga Buxheti i Shtetit. Megjithatë, Agjencia ka të drejtë të përfitojë projekte të financuara nga buxheti i shtetit apo subjekte të tjera.

Agjencia siguron të ardhura për shërbimet që ofron, në zbatim të detyrave sipas ligjit për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe të legjislacionit që prek veprimtarinë e Agjencisë në fushën minerare, hidrokarbure dhe energjitike, por pa u kufizuar vetëm në to. Buxheti i Agjencisë miratohet nga Ministri përgjegjës për energjinë.

Neni 5

Objekti i Statut-Rregullores

Statut-Rregullorja miratohet sipas parashikimeve të Vendimit Nr. 547, datë 09.08.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, i ndryshuar dhe ka për qëllim përcaktimin e funksionimit të Agjencisë, strukturën organizative të saj, strukturën e pagave, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre.

KREU II

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 6

Organet Drejtuese

Organet Drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore janë:

1. Këshilli Drejtues
2. Drejtori Ekzekutiv.

Neni 7

Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organ kolegjal vendim-marrës, për mbikëqyrjen e funksionimit dhe veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.
2. Këshilli Drejtues përbëhet nga 7 anëtarë dhe kryesohet nga Kryetari i saj.
3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen dhe lirohen nga Ministri.
4. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues, caktohet sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 8

Funksionimi i Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues zhvillon mbledhjet, si rregull, në vendin, ku ka selinë Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

2. Këshilli Drejtues zhvillon veprimtarinë, nëpërmjet mbledhjeve të anëtarëve të tij dhe marrjes së vendimeve. Mbledhjet quhen të vlefshme kur në to, marrin pjesë jo më pak se katër anëtar. Mbledhjet e Këshillit Drejtues zhvillohen jo më pak se dy herë në vit dhe në raste të tjera, kur kërkohet nga Kryetari i Këshillit Drejtues, 1/3 e anëtarëve të Këshillit, apo nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë. Ministri ka të drejtë të thërrasë mbledhjen e Këshillit Drejtues, kurdoherë që e vlerëson të nevojshme.
3. Këshilli Drejtues, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh Sekretarin e Këshillit.
4. Të gjithë anëtarët duhet të informohen me shkrim, jo më pak se 5 (pesë) ditë para mbledhjes, për problemet që do të diskutohen dhe duhet t'u vihen në dispozicion materialet paraprake.
5. Mbledhjet e Këshillit Drejtues drejtohen nga Kryetari i Këshillit dhe në mungesë të tij, nga një anëtar i autorizuar prej tij.
6. Çdo anëtar, i pranishëm në mbledhjen e Këshillit Drejtues, ka të drejtën e një vote. Vendimet e Këshillit Drejtues merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm. Kur numri i votave është i barabartë, vota e Kryetarit është vendimtare.
7. Mbledhjet e Këshillit Drejtues dokumentohen me proces-verbal, i cili mbahet nga Sekretari i këtij Këshilli dhe firmoset nga ky i fundit dhe të gjithë anëtarët e pranishëm.
8. Vendimet e Këshillit Drejtues firmosen nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje..
9. Në mbledhjet e Këshillit Drejtues mund të thirren, për të marrë pjesë, me kërkesë të Kryetarit ose anëtarëve edhe punonjës të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, ose ekspertë të jashtëm, të cilët nuk kanë të drejtë vote.

Neni 9

Kompetencat e Këshillit Drejtues

1. Mbikëqyr dhe vlerëson, të gjithë punën e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, në mënyrë periodike dhe informon Ministrin.
2. Merr në shqyrtim programin ekonomik dhe financiar të institucionit dhe ia paraqet për miratim Ministrin përgjegjës për energjinë, si dhe analizon periodikisht zbatimin e treguesve të këtij programi.
3. Merr në shqyrtim dhe miraton programin vjetor të punës së Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore
4. Propozon ndryshime në lidhje me strukturën organizative të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, të cilat i paraqiten Ministrin për miratim.
5. Shqyrton dhe propozon nevojën për ndryshim të Statut-Rregullores së funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe ia paraqet për miratim Ministrin.
6. Në çdo rast që e gjykon të nevojshëm, kërkon informacion lidhur me veprimtarinë e Agjencisë.

7. Miraton paraprakisht rregulloren/et e brendshme të funksionimit Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, bazuar në propozimet e Agjencisë dhe ia përcjell për miratim përfundimtar Ministrit.
8. Miraton paraprakisht strukturën e pagave e shpërblimeve të propozuar nga Agjencia dhe ia paraqet ato për miratim përfundimtar Ministrit.

Neni 10

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë

Drejtori Ekzekutivi i Agjencisë emërohet dhe lirohet nga Ministri përgjegjës për energjinë.

Neni 11

Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv

1. Organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, nëpërmjet urdhrave dhe udhëzimeve, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me këtë Statut-Rregullore, për përmbushjen e misionit, për të cilin është krijuar AKBN.
2. Bashkërendon punën e drejtorive të Agjencisë, për të siguruar veprimtari sa më efektive të saj.
3. Emëron, liron, apo shkarkon nga detyra punonjësit e Agjencisë, si dhe jep masa administrative për rastet e shkeljes së disiplinës dhe etikës në institucion, si dhe raste të tjera, të përcaktuara nga legjislacioni i punës.
4. Përfaqëson Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në marrëdhënie me të tretët, si dhe nënshkruan kontrata.
5. Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë, që brenda kompetencave të tij t'u japë, një ose disa punonjësve të Agjencisë, të drejtën për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh.
6. Miraton përshkrimet e punës së punonjësve të Agjencisë.
7. Ka të drejtën dhe përgjegjësinë e administrimit të fondeve në bazë të buxhetit të aprovuar nga Këshilli Drejtues dhe ministri.
8. Kërkon, kur e sheh të nevojshme, ndihmën e specializuar nga konsulentë jashtë Agjencisë ose studio profesionale brenda dhe jashtë vendit, për rastet e përjashtuara nga ligji i prokurimit publik. Mënyra dhe procedura për përzgjedhjen e konsulentëve të jashtëm do të përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të Agjencisë.

Neni 12

Struktura dhe Organika

Struktura dhe organika e AKBN miratohen nga Ministri dhe i bashkëngjiten Statut-Rregullores, si pjesë përbërëse të saj.

Neni 13

Kabineti i Drejtorit Ekzekutiv

Kabineti është strukturë ndihmëse e Drejtorit Ekzekutiv, i cili funksionon si organ këshillimor dhe e mbështet drejtpërdrejtë atë në realizimin e objektivave të Agjencisë.

Kabineti përbëhet nga:

- a) Drejtori i Kabinetit;
- b) Këshilltarët.

Neni 13/1

Detyrat e Kabinetit të Drejtorit Ekzekutiv

Kabineti asiston Drejtorin Ekzekutiv në drejtimin e përgjithshëm të Agjencisë nëpërmjet koordinimit të punës së strukturave të brendshme, si dhe në angazhimet e tij në marrëdhënie me institucionet shtetërore dhe entet e tjera publike dhe private.

Drejtori i Kabinetit dhe Këshilltarët si struktura këshillimore pranë Drejtorit Ekzekutiv në fushën e veprimtarisë së Agjencisë, kanë këto detyra:

- a) Asistojnë Drejtorin Ekzekutiv në shqyrtimin e çështjeve brenda kompetencave të tij.
- b) Marrin informacion nga Divizionet dhe drejtoritë e Agjencisë, për fushat që ato mbulojnë, me qëllim këshillimin e Drejtorit Ekzekutiv.
- c) Bashkëpunojnë me Divizionet dhe drejtoritë përkatëse të Agjencisë, për respektimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore që veprojnë në fushën minerare, hidrokarbure, burimeve të energjisë së rinovueshme (ujë, diell, era, biomasa, etj).
- d) Bashkëpunon me drejtoritë teknike dhe sektorin e projekteve për hulumtimin dhe nxitjen e pjesëmarrjes së Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore në projekte kombëtare e ndërkombëtare, në fushën e burimeve natyrore.
- e) Përgatitjen dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushën e minierave, hidrokarbureve dhe energjive të rinovueshme, ku marrim pjesë Drejtori Ekzekutiv dhe administrata e Agjencisë.
- f) Kryejnë çdo detyrë të ngarkuar nga Drejtori Ekzekutiv.
- g) Drejtori i Kabinetit dhe Këshilltarët, emërohen dhe lirohen nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.

Neni 14

Divizionet dhe Drejtoritë e Agjencisë

1. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është e organizuar mbi bazën e Divizioneve dhe Drejtorive të cilët funksionojnë bazuar në detyrat e përcaktuara në këtë Statut-Rregullore, Rregulloren e Brendshme si dhe në Përshkrimet e Punës së Agjencisë.
2. Divizionet dhe Drejtoria e Monitorimit janë në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit Ekzekutiv.
3. Divizioni Teknik ka në përbërje tre drejtori, si më poshtë:
 - Drejtoria Minerare (3 Sektorë)
 - Drejtoria Hidrokarbure (4 Sektorë)
 - Drejtoria e Energjive të Rinovueshme (3 Sektorë)
4. Divizioni Administrativ ka në përbrje tre drejtori, si më poshtë:
 - Drejtoria Ligjore (3 Sektorë)
 - Drejtoria Ekonomike (2 Sektorë)
 - Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (5 Sektorë)
5. Drejtoria e Monitorimit ka në përbërje (3 Sektorë)
 - Sektori i Monitorimit të Energjive të Rinovueshme;
 - Sektori i Monitorimit Minerar;
 - Sektori i Auditimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure.

Neni 15

Objekti i Veprimtarisë së Divizionit Teknik

Divizioni Teknik është struktura përgjegjëse pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, e cila përfshin në përbërje të saj drejtorinë hidrokarbure, drejtorinë minerare dhe drejtorinë e energjisë së rinovueshme.

Objekti i veprimtarisë së Divizionit Teknik konsiston në:

1. Konsultimin, propozimin dhe bashkëpunimin me strukturat përkatëse të qeverisë për hartimin e politikave të saj në fushën e minierave, të hidrokarbureve dhe të energjitikës;
2. Zbaton politikat e qeverisë në fushën e minierave, të hidrokarbureve dhe energjitike;
3. Siguron, brenda fushës së veprimtarisë së divizionit, oponencën teknike për studimet dhe projektet në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike, të paraqitura nga subjektet, shtetërore apo private, vendase ose të huaja. Për raste të veçanta mund të kërkojë asistencë të specializuar;
4. Promovon burimet minerare, hidrokarbure dhe burimet e rinovueshme të energjisë në zbatim të politikave të qeverisë;
5. Asiston Drejtorinë e Monitorimit gjatë procesit të auditimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure, monitorimet në terren të lejeve minerare dhe kontratave koncesionare dhe jo vetëm;

6. Mban komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Monitorimit lidhur me objektin e veprimtarisë përkatës;
7. Merr pjesë në negociatat për marrëveshjet hidrokarbure, lejet minerare si dhe kontratat koncesionare ose jo objekt koncesioni në fushën e energjitikës sipas nevojave të strukturave përkatëse të qeverisë;
8. Ndjek zbatimin e marrëveshjeve të lidhura hidrokarbure, lejeve minerare si dhe kontratave koncesionare ose jo objekt koncesioni në fushën e energjetikës si dhe ndjek zbatimin e planeve të zhvillimit të tyre;
9. Menaxhon burimet njerëzore të divizionit dhe ndan detyrat ndërmjet drejtorive të divizionit;
10. Monitoron punën e drejtorive të divizionit dhe raporton tek Drejtori Ekzekutiv;
11. Siguron respektimin e afateve dhe të procedurave gjatë kryerjes së punës.

Neni 16

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë Minerare

1. Konsulton, propozon dhe bashkëpunon, me strukturat përkatëse të linjës për hartimin e politikave të saj në fushën minerare;
2. Zbaton politikat e Qeverisë në fushën minerare;
3. Siguron, brenda fushës së veprimtarisë së vet, oponencën teknike për lejet minerare, studimet dhe projektet në fushën minerare dhe postminerare;
4. Promovon burimet minerare, negocion marrëveshjet minerare dhe ndjek zbatimin e planit të zhvillimit të tyre në zbatim të politikave të qeverisë në këtë sektor;
5. Vlerëson shkallën e rrezikut minerar, efektet e mundshme dhe propozon masat që duhet të merren për parandalimin e tyre;
6. Siguron të dhënat parësore, që lidhen me veprimtarinë minerare dhe postminerare.
7. Organizon azhurnimin periodik me sektorin e projekteve minerare dhe industriale në ministri të lejeve të reja të dhëna nga ministria.
8. Bashkërendon punën me Drejtorinë e Monitorimit lidhur me monitorimet e kryera në terren nga kjo drejtori.
9. Shqyrton kërkesat për miratimet e planeve vjetore të punës së subjekteve minerare.
10. Aplikon masa administrative konform legjislacionit minerar në fuqi.
11. Kryen analiza laboratorike pranë Laboratorit Minerar të Pasurimit të Agjencisë.
12. Mban dhe përditëson të dhënat mbi aktivitetin minerar të subjekteve që operojnë në këtë sektor.
13. Mban dhe përditëson të dhëna mbi gjendjen teknike të objekteve ku ushtrohet aktivitet minerar, si dhe të dhëna statistikore mbi nivelin e prodhimit dhe treguesit cilësorë, për secilin objekt ne veçanti.

Neni 17

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë Hidrokarbure

1. Ndjek dhe zbaton kërkesat e Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 "*Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)*", të ndryshuar dhe akteve nën ligjore të dala në bazë dhe në zbatim të tij, në fushën e kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve;
2. Promovon burimet hidrokarbure, merr pjesë në negocimin e marrëveshjeve hidrokarbure dhe ndjek zbatimin e planit të zhvillimit të tyre në zbatim të politikave të qeverisë;
3. Ndjek zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure të lidhura, sipas legjislacionit në fuqi;
4. Asiston teknikisht Sektorin e Auditimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure pranë Drejtorisë së Monitorimit gjatë procesit të auditimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure;
5. Mbështet kontraktorët e Marrëveshjeve Hidrokarbure për dhënien e lejeve, licencave e autorizimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi për të mundësuar kryerjen e operacioneve hidrokarbure;
6. Monitoron zbatimin e planeve të zhvillimit dhe programeve të punës dhe buxheteve të kryera nga kompanitë e ndryshme që operojnë në kuadër të Licencave apo Marrëveshjeve Hidrokarbure të miratuara;
7. Administron, mirëmban, përdor e përpunon, sipas teknikave dhe standardeve ndërkombëtare, të dhënat primare të sektorit hidrokarbur.
8. Ndjek zbatimin e Procedurave për Përrjashtimet nga Detyrimet (Doganore - Tvsh), të kompanive që kryejnë operacione hidrokarbure në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të përjashtimit nga TVSH dhe detyrimeve doganore.
9. Administron si dhe përgatit vërtetimet për përjashtimin nga detyrimet doganore dhe TVSH-ja, ndaj kompanive që kryejnë operacione hidrokarbure.
10. Përpunon dhe mban bazë të dhënash për të gjithë praktikatat e administruara dhe lëshuara për përjashtimin nga detyrimet doganore dhe TVSH-ja.

Neni 18

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë së Energjive të Rinovueshme

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë së Energjive të Rinovueshme konsiston në:

1. Përgatitjen dhe hartimin e raporteve të vlerësimit të investimit të impianteve elektrik me burime të rinovueshme dhe testimi i këtyre impianteve (HEC, park fotovoltaike, eoilike etj), si dhe lëshimin e Certifikatës të përfundimit të impiantit me burime të rinovueshme;
2. Promovimin e burimeve të energjive të rinovueshme në zbatim të politikave të qeverisë;
3. Përllogaritjen dhe aplikimin e penalteteve të shoqërisë për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale;
4. Krijimin, regjistrimin, përditësimin dhe publikimin e regjistrit të prodhuesve me përparësi;

5. Regjistrimin e energjisë elektrike të prodhuar në baza mujore nga secili prodhues me përparës;
6. Dhënien e kontributit në hartimin dhe rishikimet periodike, në bashkëpunim me ministrinë, të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës brenda afateve të përcaktuara me ligj;
7. Monitorimin e të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës dhe dhënia e ndihmës së specializuar strukturave përkatëse të Qeverisë në hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e energjisë.
8. Krijimin dhe paraqitjen pranë ministrisë dhe ERE-s deri më 1 qershor, të cdo viti të nje vlerësimi të pjesës së energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme në krahasim me konsumin final bruto të energjisë për vitin paraardhës.
9. Siguron, brenda fushës së veprimtarisë së vet, oponencën teknike të impianteve elektrik me burime të rinovueshme (HEC, park fotovolatik, eolik etj).
10. Promovimi e burimeve të rinovueshme të energjisë, si dhe propozon masa për rritjen e shfrytëzimit të energjisë në ciklin e saj.
11. Hartimin dhe publikimin e bilancit energjetik vjetor, në nivel kombëtar dhe rajonal, në përputhje me formatet e EUROSTAT-it dhe të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë.

Neni 19

Objekti i veprimtarisë së Divizionit Administrativ

Divizioni Administrativ është struktura përgjegjëse pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, e cila përfshin në përbërje të saj drejtorinë ligjore, drejtorinë ekonomike dhe drejtorinë e shërbimeve mbështetëse.

Objekti i veprimtarisë së Divizionit Administrativ konsiston në:

1. Rregullimin dhe kryerjen e veprimtarisë juridike dhe legislative në përputhje me dispozitat në fuqi që veprojnë në fushën minerare, hidorkarbure dhe të energjisë së rinovueshme.
2. Hartimi dhe ndjekja e programeve dhe strategjive në funksion të zhvillimit të procedurave të rekrutimit dhe të rritjes profesionale, si dhe të administrimit të sektorit të arkivës dhe protokollit.
3. Administrimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore sipas legjislacionit në fuqi.
4. Koordinimi sa më efektiv për zgjidhjen e ankesave që mbërrijnë në institucion si dhe monitorimi për plotësimin në kohë të detyrimeve të ndërmarra, në kuadër të Programit të Zhvillimit të Agjencisë.
5. Administrimi i veprimtarisë ekonomiko-financiare të Agjencisë, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Monitoron ecurinë e projekteve me financim buxhetor dhe jo buxhetor.

7. Menaxhon burimet njerëzore të divizionit dhe ndan detyrat ndërmjet drejtorive të divizionit;
8. Monitoron punën e drejtorive të divizionit;
9. Siguron respektimin e afateve dhe të procedurave gjatë kryerjes së punës.

Neni 20

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë Ligjore

1. Të mbështesë strukturat e specializuara për krijimin e infrastrukturës dhe burimet e domosdoshme që garantojnë funksionimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së Agjencisë, duke zbatuar legjislacionin në fuqi dhe këtë Statut-Rregulloren.
2. Të mbështesë drejtoritë e Agjencisë me qëllim funksionimin dhe kryerjen e veprimtarisë së tyre në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi që veprojnë në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe të energjisë së rinovueshme.
3. Të japë opinione dhe konsulenca strukturave në Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, mbi përputhshmërinë ligjore gjatë hartimit të projektakteve nënligjore, udhëzime, urdhëra, rregullore, marrëveshje, kontrata, vendime, etj;
4. Përfaqëson Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore me autorizim të Drejtorit Ekzekutiv në instancat gjyqësore dhe administrative në nivele ndërinstitucionale.
5. Promovimi i punës së Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për burimet natyrore të energjisë në Shqipëri dhe përcjellja tek publiku i një imazhi pozitiv të punës së bërë.
6. Harton dokumentacionin përkatës për pjesëmarrje dhe organizime në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me Kabinetin e Drejtorit Ekzekutiv.
7. Siguron trajtimin në kohë dhe sipas dispozitave ligjore në fuqi të ankesave dhe kërkesave të paraqitura nga individë dhe subjekte privatë pranë Agjencisë, për një qasje transparente të marrëdhënieve me publikun,

Neni 21

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë Ekonomike

1. Administron veprimtarinë ekonomiko - financiare të Agjencisë, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Përgatit projekt- buxhetin e Agjencisë;
3. Përgatit analizën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe nxjerr rezultatin financiar të Agjencisë si dhe përgatit programin e zhvillimit të Agjencisë.
4. Përgatit sipas rastit pagat e anëtarëve të grupit të oponencës teknike sipas legjislacionit në fuqi.
5. Në bashkëpunim me kabinetin dhe drejtoritë teknike përkatëse, hulumton dhe nxit pjesëmarrjen e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore në projekte kombëtare e ndërkombëtare në fushën e burimeve natyrore.
6. Ndjek ecurinë e projekteve me financim buxhetor dhe jobuxhetor.

7. Asiston çështjet ekonomiko-financiare në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Agjencisë sipas nevojave të tyre.
8. Sipas urdhrave të Drejtorit Ekzekutiv komunikon me institucionet qendrore, lokale, financiare dhe kompani të ndryshme në funksion të realizimit të misionit të drejtorisë.

Neni 22

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse

1. Siguron dhe menaxhon shërbimet ndihmëse dhe administrative;
2. Rregullon dhe kujdeset për administrimin e Burimeve Njerëzore;
3. Bashkërendon punën për zhvillimin e strategjisë së planifikimit të Burimeve Njerëzore, dhe monitoron progresin dhe produktivitetin e punonjësve të Agjencisë dhe në bashkëpunim me drejtoritë e tjera harton analizën e performancës vjetore të punonjësve.
4. Sugjeron tek Drejtori Ekzekutiv ndryshime apo përmirësime në rregulloren e brendshme të Agjencisë, në lidhje me disiplinën dhe etikën e punonjësve.
5. Nëpërmjet sektorit të IT dhe Digjitalizimit, realizon përmbushjen e detyrave dhe siguron mbështetjen e specializuar në fushën e IT-së për punonjësit e Agjencisë.
6. Realizon procedurat e prokurimit në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi për prokurimin publik dhe monitoron kontratat me të tretët.
7. Zbaton dispozitat ligjore për arkivat dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, për protokollimin dhe përpunimin teknik të dokumentacionit, sipas sektorëve përkatës.
8. Përgatit çdo muaj pagat e punonjësve, si dhe pagat e Këshillit Drejtues dhe Këshillit Teknik sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 23

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë së Monitorimit

Drejtoria e Monitorimit është struktura përgjegjëse pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore e cila përfshin në përbërje të saj sektorët e monitorimit të burimeve natyrore.

Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Monitorimit konsiston në:

1. Monitoron në terren operacionet apo proceset e punës të subjekteve të cilët janë të licensuar apo të kontraktuar për shfrytëzimin e burimeve të energjisë së rinovueshme dhe minerare;
2. Auditon shpenzimet e kryera nga shoqëritë e licencuara për kryerjen e operacioneve hidrokarbure;
3. Drejtoria e monitorimit përgatit Certifikatat Vjetore të Monitorimit të impianteve elektrik me burime të rinovueshme dhe mban bashkëpunim konstant me Drejtorinë e Energjive të Rinovueshme;

4. Dërgon pranë Divizionit Teknik raportet e monitorimeve dhe auditimeve të kryera pranë subjekteve të licencuar për shfrytëzimin e burimeve natyrore;
5. Mban komunikim të vazhdueshëm me Divizionin Teknik lidhur me objektin e veprimtarisë përkatëse;
6. Propozon marrjen e masave administrative ndaj subjekteve të cilët janë në shkelje të kushteve për të cilat janë licencuar apo pajisur me leje sipas legjislacionit në fuqi për veprimtarinë e Agjencisë;
7. Harton raportet përkatës të monitorimit dhe auditit sipas kuadrit ligjor në fuqi apo kontratave përkatëse;
8. Mban bazë të dhënash lidhur me secilin prej aktiviteteve të monitoruara sipas gjendjeve teknike, faktike dhe problematikave të konstatuara gjatë monitorimeve;
9. Drejtoria e monitorimit shërben si organ i specializuar për, monitorimin e kontratave koncesionare dhe jo objekt koncesioni, të impianteve elektrik të burimeve të rinovueshme (duke përfshirë Hec, park fotovoltaiq, eolik etj), për monitorimin e lejeve minerare dhe auditimin e marrëveshjeve hidrokarbure;
10. Mbikëqyr dhe monitoron veprimtarinë minerare të prodhimit dhe përpunimit të mineraleve metalorë dhe ndërtimorë, si dhe ato postminerare dhe raporton për gjëndjen aktuale;
11. Mbikëqyr dhe monitoron zonat e shfrytëzuara, të rrezikut minerar dhe të mbylljes së veprimtarisë minerare;
12. Organizon grupe pune për kryerjen e Akt-verifikimeve në terren për të gjitha kërkesat e bëra nga subjektet private për leje të reja minerare dhe harton dokumentacionin për to.

Neni 24

Këshilli Teknik

1. Këshilli Teknik është organ kolegjal, vendim-marrës, që kryesohet nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë, i krijuar për shqyrtimin e projekteve të shfrytëzimit të burimeve natyrore.
2. Anëtarët e Këshillit Teknik emërohen nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.
3. Këshilli Teknik funksionon mbështetur në Rregulloren e tij, që miratohet nga Këshilli Drejtues.

Neni 25

Grupi i Oponencës teknike të impianteve elektrik me burime të rinovueshme (HEC, park fotovolatik, eolik)

1. Grupi për kryerjen e Oponencës Teknike të impianteve elektrike me burime të rinovueshme është strukturë e posaçme që krijohet në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, me urdhër të Ministrit përgjegjës për energjinë.

2. Grupi i Oponencës Teknike kryen oponencë për studimet e fizibilitetit për çdo projekt propozim dhe për projektet e zbatimit të impianteve elektrik me burime të rinovueshme, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi.

3. Grupi i Oponencës Teknike kryesohet nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, funksionon dhe organizohet në bazë të Rregullores e cila miratohet nga Ministri përgjegjës për energjinë.

Neni 26

Struktura e pagave

Drejtori Ekzekutiv për efekt të pagës, klasifikohet në të njëjtin nivel me sekretarin e përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për energjinë.

Pagat e punonjësve të tjerë referuar pagës së Drejtorit Ekzekutiv do të jenë në raportet e mëposhtme:

1.	Drejtor Divizioni; Drejtor Monitorimi-----	0.94
2.	Koordinatori i Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit	0.94
2.	Drejtor Kabineti, Këshilltarë-----	0.93
3.	Drejtor Drejtorie-----	0.93
4.	Shef Sektori-----	0.80
5.	Specialist i parë-----	0.65
6.	Specialist-----	0.55
7.	Asistente Ekzekutive-----	0.45
8.	Magaznier-----	0.35
9.	Mirëmbajtës-----	0.35
10.	Punonjës informacioni-----	0.35
11.	Shofer-----	0.40
12.	Sanitare-----	0.30

Neni 27

Planifikimi dhe Buxheti

Për të gjithë veprimtarinë e saj ekonomike-financiare, Agjencia përgatit programin ekonomik (buxhetin) dhe programin e zhvillimit për çdo vit kalendarik.

Për projektet e financuara nga buxheti i shtetit, Agjencia operon në përputhje me udhëzimin vjetor të Ministrisë për këtë qëllim”.

Neni 28

Kontabiliteti

Veprimtaria ekonomiko-financiare e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore pasqyrohet konform ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim.

Neni 29

Fonde Monetare

Çdo fond në llogarinë e Agjencisë që nuk shpenzohet gjatë vitit kalendarik, do të bëhet pjesë e buxhetit të Agjencisë për vitin pasardhës. Përdorimi i fondeve monetare, disponibël, bëhet vetëm për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në aktin për krijimin e saj. Përdorimi i burimeve financiare, si dhe të ardhurat nga të tretët, do të bëhen mbi bazën e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 30

Marrëdhëniet e Punës

Marrëdhëniet e punës rregullohen nga Kodi i Punës, me ndryshimet përkatëse të tij. Procedurat për punësimin, emërimin dhe lirimimin e punonjësve të Agjencisë, do të bëhen sipas kritereve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Neni 31

Rregullat e Etikës

Në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore do të zbatohen rregullat e etikës sipas legjislacionit të fuqi për etikën në administratën publike. Kur vërehen shkelje të kodit të etikës ose mungesë profesionalizmi, merren masa disiplinore deri në lirimimin ose largimin nga detyra.

Neni 32

Marrëdhëniet e Agjencisë me Ministrin

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore siguron zbatimin e detyrave që i ngarkohen nga Ministri dhe përgjigjet për realizimin e tyre.

Ai organizon raportimin periodik tek ministri, të veprimtarisë tekniko-shkencore dhe ekonomiko-financiare të Agjencisë.

Neni 33

Administrimi i Informacionit

Klasifikimi i dokumentacionit dhe ruajtja e tij, bëhet sipas legjislacionit në fuqi, metodologjisë së përpunimit të dokumentacionit dhe ruajtjes së tij.

Neni 34

Miratimi i Statut – Rregullores

Kjo Statut - Rregullore merr fuqi dhe bëhet e detyrueshme për zbatim, menjëherë, me miratimin e saj nga Ministri përgjegjës për energjinë.

Statut-Rregullorja e mëparshme shfuqizohet.

KESHILLI DREJTUES

Z. Besjan Kadiu Kryetar



Znj. Teuta Balili Anëtare



Z. Ilia Gjermani Anëtar



Z. Antonio Bushati Anëtar



Z. Mariglen Bregu Anëtar



Z. Florion Serjani Anëtar

